



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

### BORDI

### VENDIM

Nr. 113, Datë 22.07.2019

#### MBI

### **FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “IRARBA ENERGJI” SH.P.K, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHËNGJUN” ME KAPACITET TË INSTALUAR 2040 KW.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 10 pika 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.07.2019 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga Hec “Shëngjun” me kapacitet të instaluar 2040 kW

#### **Konstatoi se:**

- Shoqëria “IRARBA ENERGJI” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 405 Prot, datë 14.06.2019, ka paraqitur kërkesën për tu pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shëngjun”, me kapacitet të instaluar 2040 kW.
- Aplikimi i shoqërisë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar pjesërisht.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3; pika 4.1.4 gërmat “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5 gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria “IRARBA ENERGJI”shpk, është një shoqëri koncesionare e krijuar në zbatim të nenit 8 të Kontratës së Koncesionit nr. 10335 Rep dhe 3329 Kol datë 09.09.2013, e lidhur midis METE (aktualisht MIE) dhe bashkimit të shoqërive “V & A ENERGJI KLOS” sh.p.k dhe “AGRI Construction” sh.p.k për ndërtimin e HEC “Shëngjun”, në rrethin Mat.
- Nga sa konstatuar nga Kontrata e Koncesionit të formës BOT sipërcituar, kohëzgjatja e saj do të jetë 35 vjet nga data e efektive, me të drejtë ripërsëritje.
- Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” në nenin 10 pika 4 parashikon se: ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4 të nenit 8 të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licensimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.
- Në pikën 4 të nenit 8 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*” parashikohet se: *Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes se lejeve nga institucionet e tjera.*

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2 germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të shoqërisë).
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) germa “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). Po ashtu shoqëria duhet të dokumentojë në ERE edhe kredinë bankare të parashikuar në masën 70 % sipas Planit të Biznesit.
- Neni 9, pika 4.1.5 , germa “c” (leje mjedisore). Shoqëria ka depozituar në ERE Aktin e miratimit të Lejes së Mjedisit të Tipi B, me nr. 7488 Prot datë 03.07.2014, të Agjensisë Kombëtare të Mjedisit, lëshuar për shoqërinë “IRARBA ENERGJI” sh.p.k për ndërtimin e HEC “Shëngjun” me kapacitet të instaluar 750 kW, me prodhim vjetor energjie 5 423 062 kWh/vit. Duke qënë se kjo leje rezulton të jetë lëshuar përpara miratimit të kontratës shtesë të koncesionit nr. 240 Rep dhe Nr. 86 Kol, datë 05.04.2016, *“Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (Ndërtim – Operim - Transferim), për ndërtimin e HEC-it “Shëngjun”, e ndryshuar, të lidhur midis MIE dhe “IRARBA ENERGJI” sh.p.k, me anë të së cilës janë ndryshuar të dhënat që kanë të bëjnë me kapacitetin e instaluar të HEC-it, sasinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe vlerën e investimit, do të kërkohej shoqërisë të përcjellë në ERE lejen mjedisore të rinovuar në zbatim të ndryshimeve që ka sjellë kjo kontratë. Gjithshtu do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin*

*ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë në ERE, brenda afateve dokumentacionin e munguar te konsatuar me sipër.*

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IRARBA ENERGGJ” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Shengjun” me kapacitet të instaluar 2040 kW, për një afat 29 vjet e 1 muaj.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI I ERE**

**PETRIT AHMETI**